



Në bazë të nenit 45 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 09 Nr. 391/02-0235112 dt. 16.11.2018, pronarëve Rexhep Murina, Haki Hoda, Zejnullah Berisha, Idriz Berisha dhe Ilir Berisha nga Prishtina, me investitorit “Krap Com” shpk me seli në Prishtinë, me përfaqësues Faik Krap nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C13” të tërsisë urbane “C”, të Planit Rregullues “Mati I”, përkatësisht në lagjen “Mati I”, rr. “Lotë Vaku” hyrjet 17, 19, 21, 23 dhe “Ismet Hoti” hyrja 12, Prishtinë, Drejtoria e Urbanizimit, në procedurë administrative me datë 11.12.2018, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** pronarëve Rexhep Murina, Haki Hoda, Zejnullah Berisha, Idriz Berisha dhe Ilir Berisha nga Prishtina, me investitorit “Krap Com” shpk me seli në Prishtinë, me përfaqësues Faik Krap nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-0235112 dt. 16.11.2018, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+7, ndërtuar sipas Aktëvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-101687 dt.08.06.2016, në parcelën kadastrale nr. 1567-1 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 833/8, 833/11, 834, 834/5), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-01567-1 ZK Matiçan, që gjendet në kuadër bllokut urbanistik “C13” të tërsisë urbane “C”, të Planit Rregullues “Mati I”.

**II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi e ndërtuar në rrugën “Lotë Vaku” hyrjet 17, 19, 21, 23 dhe “Ismet Hoti” hyrja 12, në Prishtinë, do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumentacioni sipas shtojcës numër 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017.

### A r s y e t i m

Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresës “Akt përcjellës” 09 Nr. 391/02-0235112 dt. 16.11.2018, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit “Raportin Final” 09 Nr. 356-170552 dt. 16.11.2018, përpiluar nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave të inspektimit final të kësaj drejtorie.

Drejtoria e Urbanizimit pas shqyrtimit të shkresës me raportin e lartcekur, dosjen e lëndës 09 Nr. 391/02-0235112 dt. 16.11.2018, me shkresën “Plotësim Dokumentacioni” 05 Nr. 391/02-0235112 dt. 29.11.2018, ka kërkuar nga investitori që të bëjë plotësimin e kërkesës bazë, gjegjësisht ka kërkuar të

prezantoni dokumentacioni teknik sipas shprehjes numer 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të cilin dokumentacioni investitori është obliguar ta prezantoj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të plotësimit të kërkuar përmes shkresës "Plotësim dokumentacioni" 05 Nr. 391/02-0235112 dt. 03.12.2018, ka konstatuar se investitori ka prezantuar:

- Raportin e Inspektimit Final, 09 Nr. 356-170552 dt. 16.11.2018, të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës;
- Inspektimin Final të dt. 15.11.2018, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit;
- Incizimin gjeodezik, punuar nga gjeodeti i licencuar Valon Bislimi nga Gjilani me nr. të licencës 78;
- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit;
- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes;
- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit;
- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut;
- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit;
- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik;
- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit;
- Fotografji gjatë procesit të ndërtimit;
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat;
- Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi i.d.a. Petrit Ahmeti;
- Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi i.d.n. Burim Kqira;
- Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi i.d.h. Agron Nagavci;
- Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi i.d.e. Nexhmedin Durmishi;
- Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi i.d.m. Ramadan Buzhala;
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve;
- Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore.

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellsit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, 09 Nr. 356-170552 dt. 16.11.2018, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent leshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori vendosi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, mund të përdoret, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.



bazuar ne konstatimet e me sipërme u vendos si ne dispozitiv te kesaj Certifikate.  
**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie renda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.  
**I dorëzohet:** Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-0235112 DT. 11.12.2018**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu

*B. Vllasaliu*

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Lindita Beqiri

*L. Beqiri*

Drejtori,  
Ardian Olluri

